



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË  
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA  
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta\* zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 9 pika 3, lidhur me piken 4, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.35/2012", nenit 3, të Rregullores QRK Nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 23.02.2018, miratoj këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, **pas** procesit te vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, për periudhën afatshkurt dhe afatgjatë.

Neni 2

Komisioni nga neni 1, (një) i këtij vendimi përbehet prej 3, (tre) anëtarëve dhe do të ketë përbërje:

1. Shefket Kolgeci-----anëtar-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
2. Mirlinda Muqa-----anëtare-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
3. Florije Bytyçi-----anëtare-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
4. Sami Hajdaraj-----anëtar-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
5. Dugagjin Palushi-----anëtar-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit janë që të bëjnë shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, pas procesit te vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, për periudhën afatshkurt apo afatgjatë, ku komisioni lidhur me ankimin vendosi me vendim në këtë mënyrë;

- 3.1 **refuzimin e ankesës** dhe lënia në fuqi të procesit të vlerësimit final të ofertës
- 3.2 **miratimin e ankesës** dhe shfuqizimin, revokimin e procesit të vlerësimit final të ofertës.

Neni 4

Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Komunës në Suharekë.

Neni 5

5.1 Mandat i anëtareve të Komisionit zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

5.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr. 01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-16-1190, i datës 24.02.2014, mbi formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave.

**KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË**

01-Nr-620-8563  
Me datë 26.02.2018.

